



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:093156

Datë: 27.09.2023

Numri i dokumentit: 04726829

**A.nr.799/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Liridona Ajeti Kajtazi, me sekretare juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses Sh.. K.. , përfaqësuar nga avokat A.. M.. rr. "F..", P.., kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përfaqësuar nga F.. G.., me bazën juridike anulim i vendimit, në seancën e shqyrtimi gjyqësor të datës 21.09.2023, merr këtë :

**AKTGJYKIM**

**I.REFUZOHET** kërkesëpadia e paditëses Sh.. K.. , kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPM SHCK), me të cilën ka kërkuar të anulohet vendimin i të paditurës A.nr.2826 datë 20.03.2023, si dhe vendimi nr.04 datë 05.01.2023-Ministria e Punëve të Brendshme dhe të detyrohet e paditura për pagesën e shpenzimeve procedurale si dhe shpenzimet për përfaqësim në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë, si e pa bazuar.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi me padi kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPM SHCK), ka kërkuar të anulohet vendimin i të paditurës A.nr.2826 datë 20.03.2023, si dhe vendimi nr.04 datë 05.01.2023-Ministria e Punëve të Brendshme dhe të detyrohet e paditura për pagesën e shpenzimeve procedurale si dhe shpenzimet për përfaqësim në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë. Gjatë shqyrtimit gjyqësor përfaqësuesi sipas autorizimit ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe konsideroi që KPM SHCK me rastin e refuzimit të ankesës për paditësen ka vepruar në kundërshtim me të drejtën materiale, me që se Ministria e Punëve të Jashtme nuk i ka përfunduar në tërësi sistemimin e të gjitha pozitave, ashtu si e parasheh Udhëzimi nr.02/2022 të QRK/MPB, për procesin e riorganizimit të Institucioneve publike dhe sistematizimin e nëpunësve pas ristrukturimit. Pra, pas ristrukturimit të punëve të

jashtme dhe të diasporës, pala paditëse është sistemuar në mënyrë të zhvillimit rajonal, paraprakisht pa përfunduar procesi i sistemit MPJD, si dhe me rastin e ristrukturimit në pozitën e tanishme, pala paditëse është strukturuar në pozitën e cila nuk është në përputhje me profesionin e saj. Këto rrethana konsiderohen se janë të domosdoshme për tu aprovuar padia e paditëses. Duke pasur parasysh se paditësja ka qenë me akt emërim të përhershëm në Ministrinë e njëjtë, ashtu që Ligji për zyrtarët publik 06L/114, tek neni 54, transferimi në rast shuarjes së institucionit, përcakton format e transferimit, kur së pari duhet të shtjerret transferimi në institucionin ku punon, pozitat kanë qenë të lira për derisa është ristrukturuar në këtë nen dhe profesionin të cilin ka paditësja.

E paditura KPMSHCK në përgjigjen në padi ka deklaruar se pretendimet ankimore të paditësit në padi konsiderojmë që janë të pabazuar, ndërsa vendimi i Këshillit është vendim i drejtë i bazuar në dispozita ligjore duke e vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, ndërsa padia e paditësit është e pabazuar, duke propozuar të refuzohet padia e paditësit si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i këshillit i bazuar në ligj. Gjatë shqyrtimit gjyqësor përmes përfaqësuesit me autorizim ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë përgjigjes në padi, se vendimi i Këshillit është vendim i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që ka konstatuar sakët gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë Ligjin material në rasti konkret, ndërsa pretendimet e palës paditëse janë të pa qëndrueshme, nga se në rastet kur kemi shuarje apo ristrukturim të institucionit punëdhënës kjo çështje rregullohet qartë me Rregulloren për Transferim të nëpunësve civil, e cila ndër të tjerash ka përcaktuar kritere mbi bazën e të cilave do të nënshtrohen të gjithë ata nëpunës civil ku vendi i tyre i punës ndryshon për arsye të dhëna si më lartë, prandaj rasti konkret për pozitën që synon të emërohet ankuesja, Këshilli ka konstatuar se MPJD ka zbaruar drejtë dispozitat, kur kishte ardhur në përfundim që në pozitën në fjalë të emëroi nëpunësin tjetër. Pasi që është cekur edhe në arsyetimin e vendimit të Këshillit, se diferencën e pikëve e kanë bërë kualifikimet e kandidatit tjetër e që është një proces normal, i drejtë dhe i bazuar. Ndërsa lidhur me pretendimet se ankuesja është dashur të sistemohet në MPJD përpara se të transferohet në një institucion tjetër, janë të pa qëndrueshme dhe nuk gjejn mbështetje ligjore, nga se nuk mund të sistemohesh në një pozitë kritere të së cilës nuk i plotëson, për rrjedhojë Këshilli ka elaboruar pozitat e lira me vendimin e tij dhe kriteret e të cilave ankuesja nuk i ka plotësuar, andaj për rrethana të tilla Ligji material me qëllim që nëpunëse civil tu garantohet e drejta për marrëdhënie pune, ka parapara që të njëjtëve tu mundësohet transferimi në një Institucion tjetër të shërbimit civil dhe jo vetëm por duke ruajtur edhe ekuivalenten e pozitës si rrjedhojë edhe të pagës dhe ashtu është vepruar edhe në rastin konkret ku e njëjta është emëruar me akt emërim të përhershëm apo karrierës në pozitën Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike Rajonale, në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe si rrjedhojë së njëjtës i është garantuar e drejta apo vazhdimësia e marrëdhënies së punës në shërbimin publik

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 21.09.2023, gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: akt emërim i dt. 06.01.2023, vendim i dt. 20.03.2023, vendim i dt.05.01.2023, komunikim elektronik i dt.23.05.2022, 31.05.2022, formular i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm dt.22.12.2021, 29.12.2021, formular për vlerësimin e Rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë Drejtues i mesëm i ulët dhe profesionale 2020, dt.29.12.2021, certifikatë e dt. 28.07.2015, plotësim ankese

dt.26.07.2022, konkursi i dt. 20.07.2022, 27.12.2023, vendim i dt.01.08.2022, komunikim elektronik i dt.01.04.2022, 23.08.2021, 26.08.2021, 27.02.2023, 02.02.2022, 04.02.2022, 27.07.2022, 04.07.2022, 27.07.2022, 11.03.2022, ankesë 20.06.2022, formulari për Regjistrimin e ankesës, dt.03.02.2023, ankesë e dt. 03.02.2022, akt emërim i dt.12.10.2015, njoftim për Konfirmimin e Aktit të Emërimit, përvoja e punës, letër motivimi (nuk identifikohet datë), raporti i veçantë i punës i Komisionit të ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dt. 30.12.2022, diplomë e dt. 24.01.2006, 26.11.2014, vendim i dt.24.02.2022, 28.07.2022, 21.02.22, 16.03.2022, pozitat e punës MPJD, certifikatë doktorture dt.16.10.2017, diplomë dt.21.12.2011, diplomë dt.29.06.2021, diplomë 29.08.2002, vendim i dt.23.06.2014, përgjigje në ankesë dt.08.07.2022, njoftim i dt.15.03.2022, komisioni i ristrukturimit, raport i punës i dt.19.04.2022, 22.04.2022, vendim i dt.10.05.2022, mirënjohje 26.11.2022, 20.05.20, 01.10.2017, 08.11.2017, 12.10.2017, 06.07.2015, 19.04.2002, diplomë dt.15.08.2003, 2002, certifikatë maj/2003 20.06.2003, 25.12.2009, 09.11.2001, 25.10.2000, 25.10.2010, fjalor 2018, kontratë e punës dt.17.05.2009, marrëveshje 13.10.2012, transfer dt.20.09.2011, kërkesë 28.09.2011, 12.09.2011, rekomandim i dt.15.12.2020, shkresë emërimi dt 15.04.2003, 22.11.2002, vendim i dt.29.10.2019, 16.07.2008, 8.12.2017, vërtetim i dt.24.05.2006, 09.09.2015, 23.07.2021, 21.10.2003, vendim i dt.10.05.2022, 13.11.2018, kontratë dt.15.05.2006, rekomandim dt.23.06.2020, formular vlerësimi 21.11.2002, vendim i dt.05.01.2018, 09.07.2008, 01.11.2019, vërtetim 21.03.2013.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditura me padi dhe në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, gjeti se kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar.

Me vendimin e atakuar me padi konstatohet se refuzohet si e pa bazuar ankesa e këtu paditësit datës 03.02.2023 dhe mbetet në fuqi vendimi nr.148/2023 datë 05.01.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik si dhe akt emërimi AE.nr.18/2022 datë 06.01.2023.

Gjykata gjeti se e paditura, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale me rastin e shqyrtimit të ankesës së paditësit.

Gjykata konstatoi se procedura administrative e zhvilluar te e paditura dhe organi administrativ punëdhënës është kryer në përputhje të plotë me nenin 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Gjykata po ashtu gjeti se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe janë trajtuar pretendimet ankimore të paditësit.

Gjykata konstatoi se vendimi i të paditurit nuk është në kundërshtim me nenin 48 të LPA-së, për faktin që nga vlerësimi dhe analizimi i pjesës arsyetuese, gjykata erdhi në përfundim se në pjesën arsyetuese janë dhënë sqarime të detajuara edhe të dispozitave ligjore mbi të cilat është marrë vendimin i kundërshtuar me padi. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se vendimi i atakuar i marrë nga i padituri është në përputhje të plotë me nenin 47, paragrafin të LPPA-së në të cilin përcaktohet: “Neni 47-Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar 1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së

procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrative apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.

Gjykata po ashtu gjeti se pjesa arsyetuese e vendimit është në përputhje me nenin 48 të LPPA-së i cili përcakton: “Neni 48- Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim 1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Gjykata fillimisht kishte parasysh pozitën e këtu paditësit e cila pozitë referuar dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publik nuk përjashtohet nga pozita e nëpunësve civil.

Gjykata kishte parasysh Ligjin për Zyrtarët Publik neni 7 ku përcaktohet: “1. Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë”, kurse me nenin 54 të po këtij ligji përcaktohet se:” 1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; 2.2. në institucionin në të cilin është bashkuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 2.4. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, në të cilën ai i plotëson kërkesat e veçanta. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia e pranimit, në bazë të propozimit të komisionit.”.

Gjykata kishte parasysh po ashtu dispozitat nga Rregullore (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, neni 14 ku përcaktohet :” 5. Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve civil për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe

mbështetet mbi këto kritere: 5.1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; 5.2. vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë ; 5.3. kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë. 5.4. trajnimet”.

Bazuar në shkresat e lëndës edhe konstatohet se këtu paditësja referuar bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës, pas shuarjes së pozitave përkatëse si dhe ndryshimit të përshkrimit të detyrave të punës edhe sistemohet referuar vendimit të datës 05.01.2023 në pozitën Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe Analiza Sociale-Ekonomike Rajonale, duke i lëshuar akt emërimit AE.nr.18/2022 datë 06.01.2022 në Ministrinë e Zhvillimit Rajonale, përderisa konstatohet nga shkresat e lëndës se pozita në të cilën ishte e punësuar në MPJD paditësja Udhëheqëse e Departamentit për Qendrat Kulturore të Diasporës sipas Rregullores nr.01/2022, kjo pozitë nuk është paraparë dhe se është paraparë pozita Drejtor Departamenti për Diasporë, andaj rrjedhimisht edhe konstatohen ndryshime referuar pozitës të cilën mbante paditësja dhe asaj të përcaktuar me rregullore. Bazuar në shkresat e lëndës paditësja pretendon transferimin në pozitën në të cilën është sistemuar nëpunësi civil S.U, pozitë kjo Drejtor i Departamentit për Diasporë”, me pretendimin se paditësja plotëson kriteret e kërkuara për këtë pozitë. Andaj duke ju referuar transferimit –sistemimit të këtu paditësës Gjykata konstaton se i njëjti sistemin në raport me fuzionimin e Ministrive, ndryshimit të përshkrimit të detyrave të cilën e ka bartur paditësja dhe në raport me mos ekzistimin e asaj pozite, por se përcaktimi i pozitës Drejtor i Departamentit për Diasporë edhe konstatohet se nga organi punëdhënës sistemimi i paditësës në raport me nenin 54 par 2 të Ligjit për Zyrtarët Publik edhe është konform kësaj procedure referuar pozitës së sistemuar Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe Analiza Sociale-Ekonomike Rajonale, kurse në raport me pretendimin se ka plotësuar kushte për sistemim në pozitën Drejtor i Departamentit për Diasporë në raport me nëpunësin e sistemuar në këtë pozitë dhe i cili konstatohet se ka titull doktor shkence ( sipas certifikatë doktorature 16.10.2017, diplome datë 09.06.2021) edhe konstatohet se bëhet diferenca në raport me paditësen me titull LLM (diplomë datë 15.12.2014) duke pasur parasysh këtu Gjykata nenin 14 par 5 nën par 5.3 të Rregullores nr.14/2020 ku përcaktohet kriteri në mes tyre dhe kualifikimi profesional, andaj mbi këtë bazë edhe konstatohet se në raport me kualifikimin profesional nuk qëndron pretendimi i këtu paditësës se ka plotësuar kriteret për pozitën Drejtor i Departamentit për Diasporë në raport me nëpunësin e sistemuar sipas ristrukturimit.

Referuar provave për përvojën e punës në shkresat e lëndës edhe konstatohen njohuria e gjuhës angleze të këtu paditësës si njohuri elementare (A1), andaj në kuptim të nenit 54 par 3 të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe atë plotësimi të kërkesave të veçanta, e të cilat kërkesa të veçanta komisioni i ristrukturimit duhet ti shqyrtoj në raport me këto kërkesa të veçanta, e që në raport me pozitën ekuivalente si Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate kërkohet njohuri e gjuhës angleze C1-C2, Drejtor i Departamentit për Diplomaci –njohuri e gjuhës angleze C1-C2, Drejtor i Departamenti për Nato dhe Politika të Sigurisë-njohuri të gjuhës angleze ose frënge niveli C1-C-3, pozita Drejtor i Departamentit për Organizata Ndërkombëtare –njohja e ndonjëres nga gjuhët zyrtare të OKB-niveli C1-C2, Drejtor i Departamenti të Protokollit të Shtetit-njohuri të gjuhës angleze niveli C-1-C-2, pozita Udhëheqës i Departamentit për Evropë dhe BE njohuri të gjuhës angleze, frënge ose gjermane niveli B2-C-2, andaj referuar këtyre

kërkesave të veçanta të njohurisë së gjuhës angleze apo gjuhëve të huaja përkatës si në këto kritere në raport me njohurit elementare A-1 të gjuhës angleze të cilat i kishte paditësja dhe duke mos dëshmuar njohuri të gjuhës angleze të një niveli tjetër apo gjuhëve tjera përkatëse në raport me këto kritere edhe konstatohet se këtu paditësja në raport me pozitat ekuivalente të lira nuk ka ofruar dëshmi se plotëson kriteret e veçanta në kuptim të nenit 54 par 3 të Ligjit për Zyrtarët Publik. Kriteret këto të referuara si kualifikime të posaçme sipas konkurseve të administruara në shqyrtim gjyqësor. Mbi këtë bazë duke pasur parasysh se edhe para Gjykatës paditësja nuk ka ofruar prova me të cilat do të mbështeste se e njëjta ka kualifikim profesional më të lartë apo ekuivalent me nëpunësin e sistemuar në pozitën që ka pretenduar dhe po ashtu se plotëson kriteret e veçanta në raport me pozitat ekuivalente të lira edhe konstatohet se më të drejtë e paditura ka aplikuar dispozitat nga neni 54 i Ligjit për Zyrtarët Publik dhe nenin 14 i Rregullores nr.14/2020. Gjykata refuzoi pretendimet e paditësit të dhëna në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor me perëndimin se ende pa përfunduar procesi i sistemimit në MPJD paditësja është sistemuar në Ministri përkatëse për faktin se konstatohen ndryshime në pozitën e paditëses, kërkesa për kritere të veçanta në raport me pozita ekuivalente të lira dhe se një sistemim të tillë e parash edhe nenin 54 par 2 nën par 2.4 i Ligjit për Zyrtarët Publik. Po ashtu paditësja pretendime e saj nuk i mbështetur në asnjë provë të vetme me të cilën do të bënte të besueshëm pretendimet e saj. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditëses por të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njëjtat nuk i ka provuar me prova konkrete, as para të paditurit e as me padinë e ushtruar në këtë Gjykatë.

Duke u bazuar në provat e administruara dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerësoi se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike e juridike. Mbi këto arsye thëniet e paditëses në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Gjykata iu referua nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i zbatueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative përcaktohet ku përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Me nenin 319.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore i zbatueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative përcaktohet *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të të provuarit, nënkupton një detyrim për palët. Kjo lidhet me detyrimin për respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj.

Në kuptim të nenit 64 të LKA-së u vendos lidhur me shpenzimet procedurale.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 5,6,38, 43 dhe 46.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti për Çështje Administrative  
A.nr.799/2023, datë 21.09.2023

Sekretare Juridike  
Nazife Sheholli

G j y q t a r e  
Liridona Ajeti Kajtazi

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.